



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

PROCESVERBAL

Tiranë, më 20.10.2020, ora 14:00

(i përmbledhur)¹

Drejton mbledhjen

Vitore Tusha – zv/Kryetar i Këshillit

Rendi i Ditës:

1. Zhvillimi i procedurës së shortit për caktimin e anëtareve relatorë për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidatëve për vendin vakant, vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11742, datë 24.09.2020, për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

2. Të tjera.

Marrin pjesë:

1. Vitore Tusha	(zv/kryetar)
2. Fiona Papajorgji	(anëtare)
3. Arta Marku	(anëtare)
4. Saida Dollani	(anëtare)
5. Fatjona Memçaj	(anëtare)
6. Ludovik Dodaj	(anëtar)
7. Marsida Xhaferllari	(anëtar zëvendësuese)
8. Bilbil Mete	(anëtar zëvendësues)

Merr pjesë, si vëzhgues i përhershëm:

1. **Avokatit i Popullit, përfaqësuar me autorizim nga Enio Haxhimihali.**

¹ Për shkak të parashikimit shprehimisht në ligjin nr.115/2016 (neni 226 pika 1 shkronja "d", neni232 pika 2, neni 242 shkronja "c") dhe Rregullores së Brendshme të Funkcionimit të KED-së (neni 17), referuar pengesës ligjore për të bërë publike diskutimet e vetë anëtarëve të KED për çështjen e rendit të ditës, natyra përmbledhëse e procesverbalit, imponon që edhe diskutimet e Avokatit të Popullit dhe subjekteve të ftuara të pasqyrohen në mënyrë të përmbledhur. KED, disponon materialin e plotë audio dhe te zbardhur me shkrim të çdo mbledhje, sipas ligjit.

Marrin pjesë, si të ftuar, përfaqësues nga subjektet e treguara në nenin 233/2 të ligjit nr. 115/2016:

1. **Bledar Dervishaj** dhe **Katrin Treska**, përfaqësues me autorizim të Presidentit të Republikës.
2. **Mimoza Arbi**, përfaqësuese me autorizim e Kryetarit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë.
3. **Michele Lacomy**, përfaqësuese e OPDAT-it.

Vitore Tusha deklaroi hapjen e mbledhjes sipas rendit të ditës.

Verifikoi praninë e anëtarëve dhe të anëtarëve zëvendësues dhe shprehet se zonja Miranda Andoni ka njoftuar me *e-mail* se nuk mund të jetë e pranishme në këtë mbledhje për arsye objektive. Komunikoi, gjithashtu, se anëtari zëvendësues zoti Nazmi Troka nuk është paraqitur dhe nuk ka lajmëruar në lidhje me mospraninë e tij.

Vë në dukje se kjo mbledhje është thirrur sipas kërkesave të pikës 2 të nenit 7/b të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe vendimit nr. 2 për procedurat e shortit, brenda afatit 5-ditor nga publikimi i listës së kandidatëve nga organi i emërtesës, Presidenti i Republikës, realizimin e shortit për caktimin e anëtarit relator të vakancës së parakohshme të Gjykatës Kushtetuese, të shpallur në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur përsëri në datën 24.09.2020 për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

Duke qenë se në datën 19.10.2020, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë ka përcjellë në KED dhe publikuar njëkohësisht listën e kandidatëve për vendin vakant vakancë e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, shpallur në datën 28.08.2018, rishpallur në datën 21.08.2019 dhe rishpallur përsëri nga Kuvendi në datën 24.09.2020 për shkak të mbarimit para kohe të mandatit të zotit Fatos Lulo, propozon shtimin e rendit të ditës, duke vlerësuar që të plotësohen edhe kërkesat e pikës 3 të nenit 7/c të ligjit “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese” dhe bazuar në pikën 3 të nenit 16 të vendimit nr.1, datë 08.02.2019 “Për Rregulloren e Brendshme të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi”, duke propozuar shtim të rendit të ditës me këtë objekt, realizimin e shortit për caktimin e anëtarit relator për vakancën e parakohshme në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Kuvendi i Republikës në datën 28.08.2018, rishpallur në datën 21.08.2019 dhe rishpallur përsëri nga Kuvendi në datën 24.09.2020.

Fton anëtarët të shprehin mendim në lidhje me rendin e ditës dhe me propozimin për të shtuar në rendin e ditës realizimin e shortit për vakancën e krijuar dhe të shpallur nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë.

Anëtarët bien dakord me rendin e ditës dhe me shtesën që u propozua.

Enio Haxhimihali pyet nëse është njoftuar anëtari zëvendësues, pasi një nga anëtarët ka njoftuar që nuk do të jetë prezent dhe anëtari zëvendësues nuk është paraqitur.

Vitore Tusha përgjigjet se janë lajmëruar, sepse procedura e hedhjes së shortit kërkon që të jenë të pranishëm të gjithë anëtarët dhe anëtarët zëvendësues dhe për këtë qëllim ai është lajmëruar me të njëjtën mënyrë njoftimi si anëtarët dhe ju është vënë në dispozicion çdo dokumentacion edhe anëtarëve, edhe të ftuarve të tjerë.

Marsida Xhaferllari mendon, duke ditur që është detyrim ligjor pjesëmarrja, se anëtari zëvendësues nuk është njoftuar që anëtari nuk do të paraqitej, sepse në këtë rast bie detyrimi i pjesëmarrjes. “N.q.s. ai është njoftuar si anëtar zëvendësues, siç jam njoftuar unë, aktet ligjore dhe nënligjore i japin atij të drejtën e pjesëmarrjes. Në momentin që ai njoftohet që duhet të vijë në mbledhje, sepse anëtari që ti zëvendëson mungon, ai është i detyruar të paraqitet ose nëse nuk

paraqitet të justifikojë mungesën. Kam përshtypjen që për këtë po pyeste avokati, thjesht për ta sqaruar.”.

Vitore Tusha shpjegon se i ka lajmëruar të gjithë me të njëjtin format dhe në mbrëmje ka marrë informacion në lidhje me mospjesëmarrjen e zonjës Andoni dhe nuk ka bërë rilajmërim, duke pasur besimin se ai në çdo mbledhje, pavarësisht se nuk është njoftuar asnjëherë si zëvendësues me të drejtën për të qenë i pranishëm dhe për të marrë pjesë me cilësitë e anëtarit, por dhe me cilësitë e anëtarit zëvendësues, sa herë është lajmëruar është paraqitur. Fton anëtarët të shprehen nëse kanë diçka në lidhje me këtë çështje.

Anëtarët nuk kanë gjë për të shtuar.

Vitore Tusha prezanton informacionin e kërkuar nga Gjykata e Lartë dhe të përcjellë prej saj për gjendjen e sistemit ICMIS pranë kësaj gjykate, sistem i cili mundëson ose jo zhvillimin e shortit në mënyrë elektronike. Vëren se materiali që është përcjellë në datën 19.10 nga Gjykata e Lartë është i ngjashëm ose krejtësisht i njëjtë me materialin që është përcjellë janarin e këtij viti, që tregon gjendjen e këtij sistemi, cilësitë e tij dhe në mënyrë të përmbledhur pamundësinë që ky sistem të japë si rezultat organizimin e një shorti elektronik. Megjithëse është kërkesë e ligjit zhvillimi i shortit në mënyrë elektronike, e konkretizuar dhe e zbërthyer edhe në vendimin e Këshillit nr.2, ligji ka vënë edhe alternativën e zhvillimit të shortit në mënyrë manuale, procedurë që është përdorur nga Këshilli që në momentin e funksionimit të tij deri në mbledhjen e fundit kur është hedhur shorti i datës 15.01.2020. Kërkon që anëtarët të shprehin qëndrimin për organizimin e shortit në mënyrë manuale.

Fiona Papajorgji mendon të procedohet me shortin manual, pasi është një diskutim që është bërë që në mbledhjen e parë të këtij Këshilli, në momentin e konstituimit, ku janë prezantuar pamundësitë për të bërë një short elektronik dhe është pranuar shorti manual, i cili parashikohet edhe në aktin nënligjor nr.2 të KED-së.

Arta Marku thekson se përderisa është e pamundur të procedohet me shortin elektronik, atëherë të procedohet me shortin manual.

Saida Dollani është dakord me sa më sipër.

Ludovik Dodaj është dakord me shortin manual.

Fatjona Memçaj është dakord.

Vitore Tusha vë në dukje se kjo çështje duhet diskutuar, pasi duke ju rikthyer të gjitha diskutimeve e pjesëmarrësve në mbledhjet e mëparshme të KED ka një problematikë dhe shprehet që me fillimin e funksionimit të Gjykatës së Lartë kjo çështje të kihet në vëmendje, sepse ky është një detyrim ligjor i përbashkët i Gjykatës së Lartë dhe KED-së.

Marsida Xhaferllari dëshiron të përsërisë atë që ka thënë në mbledhjen e shkurtit të vitit 2020 që ligji që cakton detyrimin për zhvillimin e shortit elektronik është ligji nr.115, i miratuar dhe hyrë në fuqi në nëntor të vitit 2016: “Po vijmë në fund të vitit 2020 dhe nuk më duket fare serioze që paraqitet i njëjti raport mbledhje për mbledhje kur vjen radha e shortit dhe thuhet që nuk kemi mundësi teknike, e para. E dyta, nuk më duket serioze dhe kërkoj, sugjeroj se nuk jam në situatën e kërkuesit, që të verifikohen veprimet që janë kryer nga drejtuesi i KED-së për këtë çështje, sepse e mbaj mend që ne e diskutuam vonesën e implementimit të këtij sistemi, e kemi diskutuar, kanë qenë prezente misionet e asistencës të EURALIUS-it dhe OPDAT-it, dhe i kemi thënë kryetarit të KED-së që nëse ka nevojë për asistencë t’i japë institucioneve të asistencës të bëjnë analizën dhe t’i japë rrugë si bëhet ky detyrim që të mos vijmë në janarin e vitit 2021 me të njëjtën situatë që t’i paraqitet KED-së një material, një raport me të njëjtën përmbajtje që mungon totalisht prioriteti”.

Enio Haxhimihali merr fjalën: “Ashtu siç e kemi thënë edhe në raportin e veçantë që i kemi drejtuar Kuvendit në mars të këtij viti për punën e KED-së 2019, një nga çështjet që kemi konstatuar ishte pikërisht hedhja e shortit në mënyrë manuale. Pra për sa kohë që ligji parashikon një detyrim të tillë, do të duhej që në rast se një gjë e tillë ishte e pamundur, ose të bëheshin amendimet ligjore, që të zgjidhej nga ana ligjore, ose në të kundërtën, të sigurohen fondet e nevojshme. Prandaj në fillim të mbledhjes së parë të këtij viti nga ish-kryetari i KED është prezantuar ky problem, është thënë që mendojmë se do të gjejmë fondet në kuadër të asistencës ndërkombëtare. Kështu që nuk e di nëse ka ndonjë informacion më tepër, çfarë veprimesh janë bërë për të siguruar këto fonde? A i janë kërkuar këto fonde institucioneve shtetërore të administratës publike përkatëse? Apo janë bërë përpjekje tek donatorët ndërkombëtare? Sepse një situatë e tillë, siç e tha edhe parafolësja, nuk është normale, që një detyrim ligjor të anashkalohet. Pra kjo situatë do të dojë ose zgjidhje ligjore, apo ndonjë zgjidhje tjetër konkrete, në se ka nevojë për mbështetje nga institucionet. Pra ka ardhur një përgjigje nga Ministria e Financave, e cila thotë për këtë apo atë arsye në KED-së 2020 nuk mund t’i japim fonde? Ky është një shqetësim i të gjithë faktorëve, qoftë kombëtarë apo ndërkombëtarë, nga institucionet më të larta, Kryetari i Kuvendit, Presidenti i Republikës. Ne jemi të gatshëm të japim të gjithë mbështetjen tonë, apo të dërgojmë shkresa, apo të përdorim mjete të tjera të presionit pozitiv për zgjidhjen e këtij problemi. Pra, na thoni çfarë kontributi mund të japim edhe ne, sepse e kemi konstatuar edhe ne më parë si problem dhe jemi të gatshëm të mbështesim KED-në në zgjidhjen e kësaj çështjeje”.

Bledar Dervishaj merr fjalën: “Është e vërtetë që 4 vjet, siç tha edhe zonja Xhaferllari, ligji përmban detyrimin që Gjykata e Lartë të ketë sistem elektronik të menaxhimit të çështjeve, ku të përfshijë edhe një modul të shortimit elektronik. Ne nuk e dimë nëse ai modul ekzistonte për çështjet në Gjykatën e Lartë apo shorti edhe këtu bëhet manual apo elektronik, por për KED-në nuk është bërë short elektronik. Megjithatë, ne nuk mund të themi që shortet që janë bërë nga KED-ja, nuk kanë qenë normale. Të gjitha shortet janë bërë manuale dhe këtë hapësirë e krijojnë vetë ligji i cili citon se: në rast se nuk ekziston dhe nuk është funksional një sistem elektronik, kalojmë tek ai manual. Këtë ka bërë edhe KED-ja me aktet nënligjore, u ka hapur rrugë edhe situatave hipotetike që s’janë hipotetike më tani, sepse janë të përsëritura. Ndoshta kjo KED dhe nën kryesimin tuaj, zonja Tusha duhet t’i bëjë një kërkesë Gjykatës së Lartë, që tashmë ka 3 anëtarë, shpresojmë që do të bëhet edhe me më shumë, që të marrë masa që për KED-në 2021 shortet të hidhen siç e kërkon rregulli primar i ligjit. Të investojë edhe në këtë drejtim, të mos shikojë vetëm menaxhimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë, por të kujdeset dhe të mbështesë teknikisht edhe KED-në. Ne jemi për hedhjen e shortit dhe të mos vonohemi.”.

Vitore Tusha fton anëtarët të votojnë nëse bien dakord të përdorin sistemin e votimit manual.

Anëtarët shprehen se janë dakord.

Vitore Tusha sqaron se në procesin e hedhjes së shortit do të përfshihen anëtarët e KED-së që janë të pranishëm, zonja Miranda Andoni, siç u vu në dukje në fillim të mbledhjes, nuk është e pranishme.

Pyet anëtarët nëse kanë pyetje, koment apo sugjerim.

Fatjona Memçaj i drejtohet zv/kryetares pasi ka konstatuar nga listat e bëra publike, se në të dyja këto lista një nga kandidatet është anëtar i familjes (ka lidhje të afërta familjare), është motra e bashkëshortit të saj, zonja Ardita Arsula. Për rrjedhojë shprehet se gjendet në kushtet e pengesës ligjore për të marrë pjesë në short, kërkesë që do ta depozitojë me shkrim.

Vitore Tusha sqaron se kjo kandidatë ka konkurruar dhe më parë dhe në këto raste znj. Memçaj i është pranuar kërkesa për të mos marrë pjesë në short.

Pyet anëtarët nëse kanë ndonjë vërejtje ose koment.

Anëtarët nuk kanë vërejtje ose komente.

Vitore Tusha informon se për vakancën e parakohshme për shkak të mbarimit të mandatit të zotit Besnik Muçi, kanë paraqitur ankim disa kandidatë dhe më konkretisht: Sergjio Mazreku, seanca e të cilit është në datën 21.10.2020, Sinan Tafaj, i cili ka kundërshtuar edhe vendimin nr. 4 të KED-së dhe Zhaklina Peto. Ajo informon gjithashtu se të gjitha vendimet, edhe ato të datës 9, janë arsyetuar, publikuar dhe u janë komunikuar kandidatëve.

Saida Dollani kërkon fjalën dhe shprehet se ligji nr. 115 nuk e pengon procedurën e vlerësimit nëse kanë bërë ankim kandidatët, por vazhdohet me vlerësimin e kandidatëve të lejuar. Në përputhje me këto dispozita të ligjit shprehet edhe Rregullorja. Pyet nëse bazuar në nenin 39 të vendimit nr.5 të KED-së, brenda afatit 5-ditor pas njoftimit të relatores, është njoftuar apo jo për pikëzimin.

Bledar Dervishaj shprehet se duke kuptuar shqetësimin e anëtares, kjo ka të bëjë me procesin e vlerësimit, i cili nuk ndërpritet nga procesi gjyqësor. Pyet nëse Këshilli ka marrë një vendim për këtë. Pra është momenti të hyjë Këshilli në një vendimmarrje të tillë për të kaluar në këtë fazë pa vlerësimin e relatores? Shprehet se nëse Këshilli do të kishte vendosur, do ta kishte bërë atë ditë që vendosi përfundimin e procesit të verifikimit me vendimmarrje për të gjithë kandidatët.

Vitore Tusha ndërhyr duke u shprehur se Këshilli nëse ka hapësira ligjore e zhvillon mbledhjen shumë shpejt dhe nuk pengohet nga moslajmërimi i relatores në lidhje me këtë çështje.

Marsida Xhaferllari pyet nëse do të mblidhet Këshilli pa pasur njoftimin e relatores.

Vitore Tusha shprehet se kjo është një çështje që vlen të diskutohet, konkretisht duke iu referuar përmbajtjes së nenit 39 të aktit normativ, vendimi nr. 4/2019 i KED. Sipas kësaj dispozite, në aspektin formal relatori duhet të njoftojë përfundimin e procedurave të verifikimit të vakancës, dhe pasi të jenë përfunduar të gjitha procedurat e verifikimit thirret mbledhja e KED-së.

Fiona Papajorgji merr fjalën: “Ideja është se nuk kanë përfunduar të gjitha procedurat e verifikimit, pavarësisht se ligji nuk e pezullon procedurën në rast ankimi, por nëse na shfuqizohet një vendim nga Gjykata Administrative e Apelit, sikurse na ka ndodhur, do të na duhet ta rishqyrtojmë. Unë nuk mendoj se jemi në kushtet kur ka shumë kandidatë që mund ta vononim procedurën e pikëzimit”.

Bledar Dervishaj merr fjalën: “Është edhe pak më ndryshe, a kalon dot Këshilli me numër nën 3 kandidatë? Do të pyesim organin e emërtesës. Se ndoshta këtu është themeli i gjësë. Dhe kjo i jep drejtim të gjithës, siç e ka bërë gjithmonë se nuk ka ndonjë gjë të re. Këshilli i vitit 2019 e ka bërë këtë gjë, ngeli me dy, pyeti Presidentin, presidenti i tha: jo do ta hapim ose ma sill, se këto janë pyetjet...”.

Vitore Tusha shprehet se çështja që ngrihet është se kur nëse momenti, tani apo kur Gjykata e Apelit të mbarojë shqyrtimin, sepse dhe kandidatët që kanë ankimuar mund të jenë potencialisht në garë. Mbi këtë bazë janë hartuar aktet.

Bledar Dervishaj vë në dukje se kjo është dilema e tejzgjatjes.

Saida Dollani: “Unë mendoj një gjë përderisa ligji e lidh, vetë ligji nuk të parashikon pezullim nuk diskutohet fare nuk kemi të pezulluar, ecim avancojmë. Dhe përderisa në rregullore është bërë që relatori njofton dhe brenda 5 ditëve është në hapa sa me të shpejtë nëse nuk do të

bjerë këshilli dakord me këto hapa procedural që tha Z. Dervishaj sa më shpejt të jetë e mundur që të mos vonohemi as një sekondë në veprimtarit tona.”.

Marsida Xhaferllari shprehet se diskutimi komplikohet ngaqë relatorja e kësaj vakance nuk është e pranishme. Po ndoshta i duhet thënë relatores që sipas Rregullores, ajo të bëjë një vlerësim vetë dhe pastaj të njoftojë Këshillin, përderisa është një rregull ekzistues në rregullore që i ngarkon relatorët të bëjmë një njoftim formal dhe pse nuk është bërë herët e tjera.

Bledar Dervishaj merr fjalën dhe sqaron se: “Në 2019 pasi përfunduan të gjitha procedurat dhe ato KED, dhe ato të gjyqësorit, Këshilli mori një vendim, pezullimin e procesit të verifikimit të kandidaturave të vakancave të parakohshme të shpallur dhe njoftimin e organeve të emërtesës për vijueshmërinë e kësaj praktike. Dhe na pyetën ne, dhe ne u përgjigjëm se do i rihapim. Sepse në garë me sa mbaj mend unë ngelën dy kandidatë Besnik Muçi dhe Regleta Panajoti . Ne e rihapëm dhe që të dy kandidatët e ngelur ishin me vetting jo të formës së prerë.

Saida Dollani pyet: “Po në një rast tjetër të mëparshëm kanë ngelur dy dhe janë zgjedhur ? Apo jo?”

Bledar Dervishaj: “Jo jo, në qoftë se kanë ngelur dy gjatë momentit të përzgjedhjes, kjo i përket një tjetër faze. Për të administruar gjithmonë janë administruar 3 dhe 4 kandidatë, por duke qenë që listat parashikonin emra të njëjtë, diku përzgjedh Presidenti, diku Kuvendi, dhe në fund doli që Presidenti në njërin vakancë i ngelën dy kandidatë dhe përzgjedhi një. Kuvendi kishte dy dhe zgjedhi një dhe tek vakanca tjetër zgjedhi vetëm me një kandidat. Por kjo nuk erdhi në fazën paraprake, por në fazën e KED. I takon KED të konsideroj kur është momenti që procesi i verifikimit vlerësohet i mbyllur. Unë e di shumë mirë që KED është investuar në këtë drejtim dhe KED e di që mund të ketë kandidat që qarkullojnë KED-Gjykatë, Gjykatë-KED. Dhe ai moment duhet të vlerësohet nga relatorja që unë mendoj vlerësoj kështu dhe ia propozon këshillit.”.

Saida Dollani shprehet se sipas rregullores ajo e vlerëson.

Bledar Dervishaj: “Pastaj këshilli ta hedhë këtë kërkesë për vendimmarrje, sepse një gjë është e sigurt që gjykata nuk mund të thotë dot jo, se këtë e kam nga ligji dhe nga praktika që lejohet kandidimi, por gjithmonë maksimalisht gjykata mund të shprehet për shfuqizimin e vendimit të KED, kthimin për rishqyrtim po në KED.”.

Vitore Tusha sqaron se kishte synimin të informonte, sepse informimi në lidhje me këtë lidhet me shqetësimin që u tha në forma të ndryshme, por që është një i vetëm.

Fatjona Memçaj merr fjalën dhe shprehet se proceset gjyqësore kundër vendimeve të KEd-së ndiqen nga këshilltarët e Gjykatës së Lartë. Kryetari ka pasur me shumë informacion se relatori dhe ka njoftuar dhe informuar mbi këto procese gjyqësore dhe fakt është që është punuar shumë. Është gjykuar që të mbarojnë të gjitha proceset gjyqësore dhe të mos fillojë pikëzimi për të mos krijuar probleme me kandidatët që thirren për intervistë, pra të mos krijohen dyshime apo hamendësime dhe të anashkalohej çdo lloj përplasje. Është gjykuar që procesi i verifikimit përfundon tërësisht dhe me investimin nga Gjykata Administrative. Në këtë moment të gjithë anëtarët kanë marrë informacionin në mbledhje që ka përfunduar procesi në Gjykatën Administrative dhe është vendosur të kalohet në pikëzim duke përcaktuar pastaj dhe detajet e procedurës. Për të ndryshuar praktikë duhet ndryshuar Rregullorja.

Vitore Tusha shprehet se, duke iu referuar nenit 7/b të Gjykatës Kushtetuese, KED-ja brenda 5 ditëve nga dita e publikimit të listës së kandidatëve thërret mbledhjen e Këshillit, që shqyrton plotësimin e kushteve dhe kriterëve të kandidatëve dhe pas plotësimit të tyre, brenda 10 ditëve nga zhvillimi i mbledhjes harton një listë përfundimtare duke renditur kandidatët.

Vlerëson se nuk duhen të interpretohen vetëm këto dy norma por duhen parë në harmoni me normat e tjera të ligjit nr. 115/2016.

Fatjona Memçaj shprehet se ka një dispozitë në Rregullore për rastin kur Këshilli fillon pikëzimin dhe numri ka rënë nën tre. Vlerëson se krijohet një gjendje pasigurie dhe në këtë kontekst gjykon se Këshilli i mëparshëm ka vepruar drejt. Nëse ka mendime kundër propozon të hidhet në votim dhe të diskutohet.

Vitore Tusha shprehet se, nëse gjykata do të respektojë afatin 7-ditor që ka përcaktuar ligji, do përmbillet ky proces dhe nuk do mbetet më ky shqetësim.

Ludovik Dodaj merr fjalën dhe shprehet se ky nuk është një problem që i përket relatores, pasi në thelb do vendosi Këshilli. Dhe pse relatorja nuk është e pranishme Këshilli mund të marrë vendim në këtë mbledhje. Në lidhje me praktikën e ndjekur në Këshillin e mëparshëm duhet pritur dhe të mbyllet procesi në tërësi, që të krijohet siguri dhe në raport me Presidentin dhe pastaj të vijohet me pikëzimin.

Vitore Tusha i jep fjalën zonjës Mishel Lakomy.

Mishel Lakomy (Përthyesja): “Në fakt do të ishte mirë të ishte dhe relatorja e kësaj çështje zj. Miranda Andoni. Megjithatë me sa po shoh diskutimi është të vazhdojë duke pritur deri sa çështja të finalizohet në Gjykatën e Apelit dhe me pas të vijohet ashtu siç është bërë edhe me përpara. Megjithatë unë do t’i mëshoja faktit që çdo gjë të arrihet brenda afatit të 17 nëntorit, gjë e cila përkon dhe me pikën 33 të vendimit të KED-së nr. 4. Sapo të qartësohet pjesa e njoftimit të KED-së për përfundimin e procedurës së verifikimit, i bie që të sqarohet dhe pjesa e vendimit të arsyetuar sa i përket statusit të procedurave të verifikimit, që është pika 46 e vendimit nr 4.”.

Bledar Dervishaj: “Jashtë çështjes, interesi është që t’i përfundojë sa më shpejt procedurat. E kemi thënë me shkrim, me deklarata publike qoftë ne, qoftë Kuvendi, të ecim sa më shpejt për plotësimin e Gjykatës Kushtetuese. Dhe në këtë qasje gjithmonë duhet evidentuar gjithashtu se jetojmë edhe në një situatë pandemie (Covid-19). Duke qenë se në dy vakancat tona, një e Kuvendit dhe një e presidentit, njëra (vakanca e Kuvendit) ka vetëm tre kandidatë që janë po të njëjtët, ndërsa tek vakanca e Presidenti ka dhjetë kandidatë, lind pyetja: a mos është vendi që për vakancën tonë të këtë dy relatorë se jemi njerëz të gjallë, edhe mund të infektohemi. Kjo, në mënyrë që mos bllokohet procesi nesër pasnesër.”.

Fiona Papajorgji shprehet se aktet nënligjore të KED-së parashikojnë zëvendësim të relatorit në këto raste.

Bledar Dervishaj: “Në këtë drejtim duhet të jemi shumë të fokusuar, pasi jemi njerëz, çdo gjë mund të ndodhë, dhe kjo për të ecur sa me shpejt dhe paralelisht. Në këtë kuptim, shqetësimi ynë është: a do mundet ky KED, që këta 10 kandidatë t’i verifikojë deri në fund të vitit? Ky është qëllimi jonë.”

Vitore Tusha: “Kemi të gjithë një qëllim, që të ecim sa më shpejt, të veprojmë proceduralisht sa më shpejt. Dhe në këto vakanca do të përipiqemi që afatet të jenë shumë më të shkurtra se sa janë përcaktuar, sigurisht nëse do na ndihmojnë dhe institucionet. Duke ju sjellë në vëmendje dhe argumentin që tha Fatjona, neni 14 i vendimit nr.5, aty është gjithë interpretimi që ka bërë Këshilli i mëparshëm. Ajo është një dispozitë e përgjithshme që tregon që procedurat e përzgjedhjes së kandidatëve nëpërmjet vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes se tyre nga Këshilli fillon me thirrjen e mbledhjes jo më vonë se 5 ditë nga ajo e përfundimit të procedurave të verifikimit të të gjithë kandidatëve që kanë shprehur interesin pranë të njëjtit organ emërtese që ka shpallur vende vakante. Kur çështjet i kemi në proceset gjyqësore kemi pasigurinë e veprimeve të mëtejshme. Në ditët në vijim do të shohim. Ky është kuptimi i normës në fuqi dhe

nëse do të kemi një interpretim të ndryshëm në bashkërisht mund të vendosim ta ndryshojmë, në qoftë se kemi edhe propozime gjithmonë që t'i shërbejë ecurisë së këtij procesi.”

Saida Dollani shprehet se ka mendim tërësisht të ndryshëm qoftë dhe nga çfarë KED-ja i mëparshëm ka thënë, sepse nëse neni 238 i ligjit nr. 115 nuk do ta parashikonte shprehimisht se ankimi nuk e pezullon zhvillimin e procedurës së verifikimit dhe vlerësimit paraprak nga KED, edhe mund të pajtohej me këtë qëndrim.

Fatjona Memçaj shprehet se për shkurtim procedure, nëse ngelen dy kandidatë dhe kjo kërkon njëfarë miratimi nga organi i emërtesës, t'i niset njoftimi lidhur me vijueshmërinë e procedurës. Kjo që Këshilli të mos të mblidhet vetëm për këtë gjë me gjithë procedurat që i ka shumë të gjata, ku përfshihet njoftimi, thirrja, mbledhja etj. Nëse organi i emërtesës e pranon dhe në këtë fazë që është dakordësinë, Këshilli do ndjekë procedurat gjyqësore, çka nuk është detyrim i organit të emërtesës por e Këshillit.

Vitore Tusha shprehet se në dijeninë e saj ato i ndjekin.

Bledar Dervishaj: “Ne i ndjekim proceset gjyqësore kur na thërrasin si persona të tretë. Unë të paktën sa mbaj mend tani, kandidati Serxho Mazreku na ka thirrur si person i tretë bashkë me Kuvendin.”.

Enio Haxhimihali merr fjalën: “Nëse mundet tek pika “të tjera” të rendit të ditës, doja të shtoja se, duke qenë se edhe në këtë mbledhje, edhe në mbledhje të tjera kemi folur edhe për efikasitetin, donim të ishim konkret dhe t'i jepnim zgjidhjet në mënyrë konkrete. Madje ky nuk është një shqetësim vetëm i zyrtarëve të lartë vendas si i Presidentit, kryetarit të Kuvendit, i juaji, i joni, por edhe i faktorëve ndërkombëtarë. Ne do të donim të ishim sa më konkretë, ndaj mendoni ju që për të ecur sa më shpejt, do duhet të pezullohej përkohësisht nga detyra tjetër anëtari i KED? (duke e ditur që anëtarët e KED janë të dy punësuar, pra kanë edhe detyrë tjetër). Arsyeja që u paraqit pse relatorja Andoni nuk ndodhet sot ishin dy çështje gjyqësore, dmth detyra të tjera përveç funksionit në KED që ajo ka. Pra nëse ju e gjykoni të nevojshme që t'i drejtohet Avokati i Popullit, KLGJ-së dhe/ose KLP-së, që për një periudhë të caktuar anëtarët e KED që janë njëkohësisht gjyqtarë e prokurorë, të pezullohen përkohësisht nga çështjet e tjetra, ne jemi të gatshëm t'u mbështesim me një shkresë përkatëse, apo në çfarëdolloj forme tjetër që ne do të mundemi për të përshpejtuar procesin në KED. Pra na thoni t'ju mbështesim, që të paktën të lehtësoheni nga ngarkesat e punës dyfish që keni.”.

Vitore Tusha shprehet se kjo gjë është shqetësim, pasi anëtarët kanë punuar me ngarkesë të plotë dhe se do e vlerësonte çdo kontribut të dhënë në këtë drejtim.

Deklaron mbylljen e mbledhjes dhe vijimin me procedurën e shortit.

Mbyllet mbledhja në orën 15.15.

Tiranë, më datë 20.10.2020

Zv/KRYETARE

Vitore TUSHA